



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

**Kryesuese e Senatit**  
Prof.asoc.dr. Merita Shala

Nr. Prot. 55 Dt 05.01.2024

Në bazë të nenit 9, pika 5 dhe 6, të Rregullores 1670 të dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në mbledhjen e mbajtur më 04.01.2024, mori:

**VENDIM**

- I. Aprovohet propozim i Këshillit të Fakultetit Juridik për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, sipas konkursit me nr.prot.2067 i publikuar me dt.10.10.2023 të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për vitin akademik 2023/2024, si në vijim:  

**Jeton Hasani** - Asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura administrative, E drejta e punës;
- II. Kandidati i cili është përzgjedhur për angazhim në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajiset me kontratë varësisht prej fondit të orëve që posedojnë për vit akademik. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- III. Kontrata e punës për stafin e propozuar për angazhim, sipas raporteve të komisioneve të njësive akademike, do të përpilohen sipas dispozitave ligjore. Nënshkrimi i kontratës për angazhim do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontrata do të bëhet për vit akademik, ose një semestrale nëse kandidati është i angazhuar vetëm për një semestër akademik, duke përfshirë edhe obligimet, që dalin nga procesi mësimor.
- IV. Bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët kanë marrëdhënie pune, para nënshkrimit të kontratës duhet të sjellin dokumentin që dëshmon miratimin nga udhëheqësi më i lartë administrativ ku është i punësuar me kontratë primare (me kohë të plotë), konform nenit 4, pika 4.1, të Rregullores 09/2023 për shtesën funksionale.
- V. Dekanët e njësive akademike mbajnë përgjegjësi ligjore për rastet e konflikteve të interesit dhe nepotizmit për kandidatët e përzgjedhur.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Këshillë Juridike:** Kandidatët e pakënaqur mund të hapin kontest pranë Gjykatës kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit UIBM;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrtarit për paga;
6. Zyrës së personelit;

Prof.asoc.dr. Merita Shala

Kryesuese e Senatit

